

**STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR
“ MOUNTAIN’S GREEN ENERGY ” SH.P.K.**

Sot, me date 17/03/2021, perpilohet ky statut dhe akt themelimi nga:

Michelle Ndoka, e bija e Armando-s, e datelindjes 10/06/2002, lindur dhe banuese ne Kassel, Gjermani, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga karta e identitetit me numer personal L60X6300R

E quajtur me poshte ortake themeluese, me vullnetin e saj te lire dhe ne perputhje me ligjin nr 9901, date 14.04.2008 ” Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, si vijon:

**KREU 1
NENI 1
FORMA**

Ortaku i mesiperm krijon nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2
EMRI I SHOQERISE**

Emri i plotë dhe i saktë i shoqërisë është **“Mountain’s Green Energy” sh.p.k.**


**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga Aeroportit Nene Tereza, Ndertesa Nr. 5, Bashkia Vore, Tirane.
Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege, zyra ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

**NENI 4
KOHËZGJATJA**

Shoqeria do te kete nje kohëzgjatja te pacaktuar.
Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe nga ky moment ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me vendim të Asamblesë së Ortakëve vendoset prishja e shoqërisë, ose me mbarimin e shoqërisë në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin nr.9901“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Michelle Ndoka



NENI 5
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria "Mountain's Green Energy" sh.p.k. do të ketë si objekt të veprimtarisë:

Investime të ndryshme. Studime dhe analiza në fushën e energjisë. Projektimi i të gjitha llojeve të veprave energjetike. Ndertimi i parqeve fotovoltaike, eolike, hidrocentrale dhe biomase të të gjitha llojeve e impjanteve të ndryshme energjetike. Ndertimi i linjave të tensionit e interkonjeksionit të të gjitha niveleve të tensionit. Menaxhimi dhe operimi e veprave të ndryshme energjetike. Operimi optimal tekniko ekonomik i Hidrocentraleve, termocentraleve dhe llojeve të tjera të impjanteve të erez, termale, gjeotermale e solare për prodhimin e energjisë elektrike. Shitja e energjisë elektrike klienteve e operatoreve të ndryshëm privat apo shtetëror brenda e jashtë vendit. Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar. Përdorimin e sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjesh, transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjisë elektrike. Veprimtaria si operatori sistemit të transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike dhe të dispecerimit (axhustim ose rregullimi i prodhimit) të energjisë elektrike sipas kërkesave të konsumit, në nivel kombëtar. Shpërndarjen transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit, të mesëm dhe të ulët, duke patur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit Exportin importin dhe tranzitimin e energjisë elektrike. Import-eksport i materialeve, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve të sipërpermendura. Veprimtaria e shoqërisë do të kryhet sipas lejeve dhe licensave përkatëse të lejuara nga Autoritetet e Shtetit Shqiptar.

NENI 6
VULA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë vula të saj duke shënuar në të emërtimin tregtar ose iniciale

KREU II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT
THEMELTAR DHE TRANSFERIMI
NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është kontribut i ortakut themelues, është 100.000 (njëqind mijë) Leke i ndarë në 1 (një) kuotë.

NENI 8
KONTRIBUTET

Kontribut i përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti i ndarë në 1 (një) kuotë i takon ortakut themelues në masën :

Michelle Ndoka



- Michelle Ndoka , zoteruese e 1 (nje) kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te shoqerise

NENI 9

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen:

- Michelle Ndoka 100 %

NENI 10

Kuotat, të drejtat e lidhura me to, Fitimi

Kuotat japin të drejtën votës për të marrë vendime sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar si dhe për të ushtruar të drejta të tjera që ky ligj ia njeh ortakëve.

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ne menytrat e parashikuara nga ligji.

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklarua më pasqyrat financiare të shoqërisë.

Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Neni 11

Kuotat, Fitimi, Transferimi i kuotave


Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë, shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit, apo çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Kuotat mund të transferohen lirisht midis ortakëve.

Transferimi i kuotave bëhet me akt noterial.

Transferimi tek të tretët është i kushtëzuar nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve, që do të thotë se në rast se ndonjë nga ortakët dëshiron të transferojë një pjesë nga kuota e tij apo të gjitha kuotat takuese në kapitalin e shoqërisë, ai është i detyruar të njoftojë me shkrim ortakët e tjerë paraprakisht nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat me të njëjtat kushte dhe në të njëjtat rrethana që do t'i transferohen të tretëve. Ortakët duhet, që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit nga ortaku përkatës, të shprehen me shkrim nëse dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat e transferuara me të njëjtat kushte dhe në të njëjtat rrethana që do t'i transferoheshin të tretëve, apo nëse janë dakord që kuotat t'i transferohen të tretëve. Nëse ortakët nuk shprehen brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit, atëherë ortaku është i lirë të transferojë kuotat tek të tretët. Njoftimi për transferimin e kuotave duhet të kryhet sipas procedurës të parashikuar në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” në lidhje me mënyrën e thirrjes. Në njoftim duhet specifikuar të dhëna të tilla si: emri, mbiemri, adresa e personit që i transferohet pronësia, kuotat që do të transferohen si dhe çmimi i ofruar.

Michelle Ndoka



Kreu III
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12

Asambleja e Përgjithshme. Thirrja e mbledhjes. Kuorumi i nevojshëm. Marrja e vendimeve. E drejta e votës

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve në mbledhjet e tyre përkatëse.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet në rastet dhe në formën e parashikuar nga ligji nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike në adresat e përcaktuara jo më vonë se 7 ditë përpara datës së mbledhjes. Konsiderohet se njoftimi është kryer në rast se është konsumuar të paktën një nga mënyrat e thirrjes përcaktuar në statut. Njoftimi duhet të përmbajë: ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja; si dhe rendin e ditës. Njoftimi bëhet nga Administratori i shoqërisë.

Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme kanë të drejtë t’i drejtojnë Administratorit një kërkesë me shkrim për të thirrur Asamblenë dhe/apo përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës. Nëse kërkesa refuzohet nga Administratori, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin vetë Asamblenë dhe/apo të caktojnë çështjet e rendit të ditës.

Asambleja e Përgjithshme e thirrur në mënyrë të parregullt, mund të marre vendime të vlefshme, vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marre vendime pavaresisht parregullsisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret në rastet e parashikuara në ligjin nr.9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Asambleja e zakonshme e Ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit.

Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht ortakëve.


Në rastin e marrjes së vendimeve, për të cilat kërkohet një shumicë e zakonshme, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Për vendimet për të cilat sipas ligjit kërkohet një shumicë e kualifikuar, asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht apo votojnë nëpërmjet përfaqësuesit të caktuar prej tyre.

Asambleja vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet:

- Ndryshimi i statutit;

Michelle Ndoka



- Zmadhimi, apo zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë
- Shperndarja e fitimeve.

Për çështjet e tjera të renditura në nenin 13 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Neni 13 Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimin e Statutit;
- Ndryshimin e objektit të shoqërisë
- Emërimin/shkarkimin e Administratorit, likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimeve për ta;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Kryerjen e kontroll-revizionit financiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej saj;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratorëve;
- Te vendose për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Te vendose për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 14 Votat e ortakëve

Secili ortak mund të ushtrojë të drejtën e votës personalisht në mbledhjet e Asamblesë, apo mund të autorizojë çdo ortak tjetër apo një person të tretë nëpërmjet një prokure lëshuar nga ortaku i përfaqësuar për të marrë pjesë në mbledhje dhe për të ushtruar të drejtën e votës në emër dhe për llogari të tij.

Kreu IV ADMINISTRATORI

Neni 15 Administrimi i shoqërisë

Shoqëria administrohet nga një Administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Lorena MERE. Afati i ushtrimit të detyrës është 5 vjet me te drejte ripërtëritje. Detyra e Administratorit përfundon:

Michelle Naloka



- me mbarimin e afatit;
- me shkarkimin e tij nga Asambleja e Ortakëve;
- kur vete Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht.
- sipas mënyrave të tjera parashikuar nga ligji nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit. Përgjegjësitë

Administratori ka këto kompetenca si më poshtë:

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Përfaqëson shoqërinë tregtare;
- Kujdeset përmbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
- Kryen çdo transakcion financiar.
- Vepron në emër dhe për llogari të shoqërisë brenda kompetencave të parashikuara në statut apo në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, duke respektuar edhe kufizimet përkatëse të parashikuara në statut dhe në ligj;
- Emëron dhe të shkarkon nga puna punëmarrësit e shoqërisë.
- U jep urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
- Drejton e organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- Raporton para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- Zbaton vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme;
- I paraqet në mënyrë të rregullt Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventaritet, bilancitet dhe llogaritë vjetore brenda një afati prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar;
- Ushtron të drejta dhe detyrime të tjera të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Michelle Ndoka

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit duke zbatuar ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;

Për përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve administrative, gjyqësore ose të tretëve duhet firma e administratorit. Në rast pengesash, si sëmundje, aksidente, udhëtime etj, administratori do të autorizojë një person tjetër për përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë.

Kreu V

Marrëdhëniet ekonomike, financiare dhe tatimore

Neni 17

Veprimtaria ekonomike, financiare dhe tatimore e shoqërisë

Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. mund të lidhë kontrata me sektorët shtetërore si dhe me persona juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj.

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga administratori ose persona të tjerë të autorizuar prej tij.

Shoqëria do të përgjigjet për të gjitha detyrimet tatimore dhe fiskale që burojnë nga legjislacioni.

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose valutë të huaj.

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve që do të caktohen nga vetë shoqëria. Çmimet dhe tarifat do caktohen sipas kërkesës dhe ofertës së tregut dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi.

Të gjitha aktivitetet ekonomike, tregtare dhe tatimore do të pasqyrohen në dokumentacion të rregullt financiar dhe regjistrat përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Kreu VI

Viti Financiar. Prishja e Shoqërisë. Dispozitat e fundit.

Neni 18

Viti Financiar

Veprimet financiare mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa mbi nxjerrjen e bilancit të formuluar konform ligjeve mbi kontabilitetin.

Është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

Michelle Ndoka



Neni 19

Mbarimi i Shoqërisë

Shoqëria "Mountain's Green Energy" sh.p.k. priset për shkaqet e parashikuara në ligjin nr.9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

Neni 20

Te ndryshme

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, vlejné dispozitat e Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Shoqëria "Mountain's Green Energy" sh.p.k. do të regjistrohet dhe do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plote me këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodi Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Statuti u hartua në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtte juridike për tu administruar në baze të ligjit, një kopje për tu dotrezuar në Qendren Kombëtare të Binesit dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "Mountain's Green Energy" sh.p.k.

Neni 21

Njoftimet

Njoftimet drejtuar ortakut duhet të kryhet sipas adresave të përcaktuara në këtë statut. Ortaku është i detyruar të njoftojë ndryshimet e adresës së tij.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të treteve do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

THEMELUES

Michelle Ndoka

Michelle Ndoka

